

Conference with social partners and civil society organisations from North Macedonia

X @EESC_REX #EESC_WB

12 March 2026 | 10:00 - 16:00 | Europe House – Skopje – Sv. Kiril i Metodij 52-b



Bruksel, 9 prill 2026

RAPORT NGA KONFERENCA

Në vëmendje të pjesëmarrësve të konferencës, si dhe të të gjithë grupeve përkatëse të interesit nga institucionet e BE-së dhe autoritetet e Maqedonisë së Veriut

Qëllimi i konferencës:

Më 12 mars 2026, Komiteti Shqyrtues për Ballkanin Perëndimor organizoi një takim me palë të jashtme në “Europe House” në Shkup të Maqedonisë së Veriut. Takimi konsistoi në një konferencë me partnerë socialë lokalë dhe organizata të shoqërisë civile (OShC), me qëllimin për të dëgjuar pikëpamjet e shoqërisë civile të organizuar në Maqedoninë e Veriut mbi rolin e saj në vend dhe negociatat e ardhshme me BE-në, si dhe për të përcjellë mesazhe kyç ndaj autoriteteve të Maqedonisë së Veriut dhe institucioneve të BE-së. Takimi u mbajt pas vizitës së Grupit të Përhershëm të KESE-s për të Drejtat Themelore dhe Sundimin e Ligjit në Maqedoninë e Veriut, e cila u zhvillua më 10-11 mars 2026.¹ Ky mision faktmbledhës përfundoi me takime dypalëshe nga presidenti dhe zëvendëspresidenti i Komitetit Shqyrtues për Ballkanin Perëndimor me palë të ndryshme.

Konkluzionet kryesore

- Mbështetja publike për anëtarësimin në BE mbetet e fortë, pavarësisht pengesave të përsëritura. Për të ruajtur besimin, reformat duhet të ofrojnë përmirësime të prekshme në jetën e përditshme të qytetarëve dhe të demonstrojnë përfitimet e integritit gradual përpara anëtarësimin zyrtar.
- Pjesëmarrësit nënvizuan se ekzistonte një "dritare mundësie" me afat të kufizuar në lidhje me zgjerimin. Maqedonia e Veriut duhet ta shfrytëzojë këtë mundësi duke bërë progres drejt përmbushjes së kushteve për hapjen e grupkapitullit “Themeloret”, ndërsa BE-ja duhet të vazhdojë të inkurajojë progresin e besueshëm.

¹

Një dokument i veçantë, i titulluar *Të drejtat themelore dhe sundimi i ligjit – Raport mbi vizitën në Maqedoninë e Veriut dhe konstatimet e autoriteteve mbi raportin* do të publikohen në një fazë të mëvonshme.

- Dialogu efektiv civil dhe social është një kërkesë për anëtarësim, por edhe një mjet praktik për të përmirësuar cilësinë e politikave. Autoritetet duhet të shkojnë përtej konsultimeve formale dhe të përfshijnë partnerët socialë dhe organizatat e shoqërisë civile (OShC) në mënyrë të vazhdueshme dhe në një fazë të hershme në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave.
- Strukturat ekzistuese për dialogun civil dhe social (p.sh. Këshilli Ekonomik dhe Social dhe Këshilli për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile) takohen rregullisht, por këto takime shpesh perceptohen si thjesht procedurale. Grupet e interesit kanë kërkuar agjenda më domethënëse, përgatitje dhe monitorim më të mirë, si dhe besim më të madh midis partnerëve. Krahas kësaj, partnerët socialë theksuan se Këshilli Ekonomik dhe Social duhet të trajtojë një gamë më të gjerë reformash socio-ekonomike dhe propozimesh legislative përtej debatit të përsëritur për pagën minimale.
- Një vështirësi e përsëritur që pengon progresin në lidhje me zbatimin e acquis së BE-së është kapaciteti i kufizuar administrativ dhe qarkullimi i shpeshtë i personelit, gjë që cenon zbatimin, monitorimin dhe realizimin në kohë të reformave dhe strategjive, pavarësisht se kuadri ligjor dhe strategjik është përgjithësisht i përshtatshëm.
- Reformat kryesore të theksuara, që nuk janë realizuar përfshijnë: (i) ndryshimet kushtetuese të kërkuara nga kuadri negociues; (ii) miratimi dhe zbatimi i reformës së kodit zgjedhor në përputhje me rekomandimet e ODIHR-it, me përfshirje domethënëse të OShC-ve; dhe (iii) reforma gjithëpërfshirëse e kodit penal për të garantuar pajtueshmërinë me acquis të BE-së.
- Grupet e interesit raportuan sfida të vazhdueshme në sistemin gjyqësor, duke përfshirë mungesën kronike të fondeve dhe mungesat e gjyqtarëve dhe stafit mbështetës, të cilat rezultojnë në vonesa dhe cenojnë besueshmërinë ndaj sundimit të ligjit.
- Komuniteti i biznesit është në dijeni të mundësive që ofron anëtarësimi në BE, por ka mangësi të kanaleve të strukturuar për angazhim proaktiv dhe shfaq gatishmëri të kufizuar, veçanërisht nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), në lidhje me presionet që paraqet tregu i përbashkët. Rivendosja e mekanizmave efektivë të dialogut publik-privat dhe fuqizimi i kapacitetit të dhomave të tregtisë u identifikuan si përparësi.
- Hapësira për veprim e shoqërive civile është gjerësisht e hapur, por OShC-të përballen me cenueshmëri strukturore: financim publik të kufizuar dhe të paparashikueshëm, rregulla të komplikuar për donacionet dhe fushata të përsëritura shpifjesh, veçanërisht kundër organizatave të advokimit që janë të angazhuara në luftën kundër korrupsionit dhe pro sundimit të ligjit.
- Një ligj i ri “Për shoqatat dhe fondacionet” pritet të miratohet dhe të përmirësojë mjedisin mundësues, duke përfshirë rregulla më të qarta për financimin publik. Pjesëmarrësit gjithashtu theksuan nevojën për afate kohore të përshtatshme për konsultime (edhe për portalin e konsultimeve publike - ENER) për të shmangur pjesëmarrjen “sa për formalitet”.
- Liria e shprehjes mbetet e sfiduar nga profesionalizmi i ulët i medias, polarizimi, keqinformimi dhe gjuha e urrejtjes. Paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) u përmendën vazhdimisht si një pengesë ndaj gazetarisë investigative; prandaj, është e rëndësishme të ruhet pajtueshmëria me standardet evropiane kundër SLAPP-ve dhe në lidhje me reformat gjyqësore.
- Çështjet e barazisë gjinore mbeten shqetësuese; pjesëmarrësit theksuan problematika të vazhdueshme, duke përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe diskriminimin e vazhdueshëm ndaj grave shtatzëna në tregun e punës.

- Nisma “Anëtarët Kandidatë për Zgjerim” u vlerësua pozitivisht nga pjesëmarrësit nga Maqedonia e Veriut, të cilët inkurajuan institucionet e tjera të BE-së të publikojnë qasjet që integrojnë shoqërinë civile të organizuar nga vendet candidate në punën e BE-së.

Konferenca me përfaqësues të partnerëve socialë dhe OShC-ve nga Maqedonia e Veriut

➤ *Agjenda e bashkëngjitur*

Fjala e mirëseardhjes

- Bekim Sali, Zëvendëskryeministër i Parë dhe Ministër për Çështjet Evropiane
 - Bashkëpunimi me shoqërinë civile është thelbësor, pasi organizatat e shoqërisë civile janë bashkëhartues të politikave; prandaj, është thelbësore të sigurohet që hapësira për veprim e shoqërisë civile të mbetet e hapur, dinamike dhe efektive, dhe që proceset e konsultimit të mbahen mirëfilltazi.
 - Dialogu efektiv social është një shtyllë e demokracisë, dhe si rrjedhojë, qeveria është e përkushtuar për të përmirësuar mekanizmat e konsultimit.
 - Transparenca institucionale dhe mbështetja për median e pavarur janë thelbësore.
 - Zbatimi i suksesshëm i agjendës së reformave dhe integrimi në BE varen gjithashtu nga përfshirja e qytetarëve.
- Ben Nupnau, Zëvendësdrejtuës i Delegacionit të BE-së në Maqedoninë e Veriut
 - Reformat duhet të jenë të besueshme dhe gjithëpërfshirëse, dhe e gjithë shoqëria duhet të punojë bashkërisht në lidhje me to.
 - Dialogu social është një pjesë thelbësore e modelit social evropian; duhet të promovohen konsultimet efikase trepalëshe.
 - Strategjia e BE-së për Shoqërinë Civile dhe nisma “Mburoja Evropiane për Demokracinë”, të miratuara në vitin 2025, janë gjithashtu me rëndësi thelbësore për Maqedoninë e Veriut.
- Violeta Jelić, Presidente e Komitetit Shqyrtues për Ballkanin Perëndimor të Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian
 - KESE është tejet e interesuar që Maqedonia e Veriut të hapë grupkapitullin e parë dhe kapitujt fillestarë të negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian; kjo nxit gjithashtu riaktivizimin e Komitetit të Përbashkët Konsultativ të Shoqërisë Civile BE-Maqedoni e Veriut të KESE-s.
 - KESE është organi i parë i BE-së që zbaton parimin e anëtarësimit gradual të vendeve kandidatë në BE në punën e tij konsultative, përmes zbatimit të nismës “Anëtarët Kandidatë për Zgjerim (ECM)”.
 - Shoqëria civile e organizuar e Maqedonisë së Veriut ka pasur ndërkohë mundësinë e fjalës dhe që të kontribuojë me shkrim në opinionet e KESE-s, dhe përfaqësuesit e saj janë ulur pranë homologëve të tyre të BE-së gjatë diskutimeve në seancën plenare të KESE-s kushtuar zgjerimit.
- José Antonio Moreno Díaz, President i Grupit të Përhershëm të KESE-s për të Drejtat Themelore dhe Sundimin e Ligjit
 - Krahas takimit të jashtëm të Komitetit Shqyrtues për Ballkanin Perëndimor, Grupi i Përhershëm i KESE-s për të Drejtat Themelore dhe Sundimin e Ligjit ka zhvilluar gjithashtu vizitën e tij në Maqedoninë e Veriut në të njëjtën javë, duke dëshmuar angazhimin e Komitetit në Maqedoninë e Veriut; gjatë kësaj vizite u identifikuan probleme në lidhje me dialogun social dhe zbatimin e pamjaftueshëm të të drejtave të

punonjësve, veçanërisht në zonat e tregtisë së lirë, si dhe me diskriminimin e vazhdueshëm ndaj grave shtatzëna në tregun e punës.

- Maqedonia e Veriut ka një kuadër ligjor të konsoliduar dhe kapacitete të mira institucionale, por ka mungesë efikasiteti dhe buxheti.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile të organizuar në negociatat e anëtarësimit me BE-në dhe zbatimi i agjendës së reformave

Pikat kryesore:

- Pjesëmarrja në procesin e anëtarësimit mbetet e fragmentuar: Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian (i krijuar në vitin 2007) ka pjesëmarrje të gjerë (30+ anëtarë) dhe diskutimet kanë tendencën që të jenë thjesht formaliste, ndërsa angazhimi me ministrinë e linjës është shpesh ad hoc.
- Nuk ka një model të vetëm të “praktikës më të mirë” për përfshirjen e shoqërisë civile të organizuar në negociata; Maqedonia e Veriut do të duhet të ngrejë një strukturë kombëtare të realizueshme, të mbështetur nga Komisioni Evropian/delegacioni i BE-së (siç është projekti aktual SUPRAE).
- Partnerët socialë duhet të përfshihen sistematikisht (jo vetëm përmes konsultimeve të rregullta të mundësuar nga delegacioni i BE-së), në mënyrë që negociatat të nxisin reforma cilësore socio-ekonomike dhe jo të shërbejnë thjesht si një proces teknokratik.
- Agjenda e reformave duhet të monitorohet nga një komitet gjithëpërfshirës që bashkon grupet kryesore të interesit (qeverinë, partnerët socialë dhe OShC-të). Kapaciteti i administratës publike vijon të mbetet i kufizuar, veçanërisht në lidhje me vlerësimet e ndikimit, monitorimin dhe publikimin në kohë të dokumenteve; integrimi në BE është një domosdoshmëri ekonomike dhe zhvillimore: BE-ja është partneri kryesor tregtar i vendit. Bizneset kanë nevojë për dialog të parashikueshëm dhe të strukturuar gjatë gjithë procesit për t'u përgatitur për presionet e tregut të përbashkët, për të ruajtur konkurrueshmërinë dhe për t'u integruar me zinxhirët e furnizimit evropian.
- Reformat duhet të gjenerojnë përmirësime konkrete në cilësinë e jetës së qytetarëve; qytetarët duhet të ndiejnë përfitimet e integritimit gradual përpara anëtarësimit zyrtar.
- Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor përforcon fokusin në konvergjencën socio-ekonomike, me afate të ngushta dhe pagesa që lidhen me realizimin e reformave; Maqedonia e Veriut duhet të veprojë shpejt dhe të përmirësojë përgatitjen e projekteve dhe kapacitetin asimilues (duke përfshirë për NVM-të dhe dhomat e tregtisë, si dhe përmes një bashkëpunimi më të fortë rajonal midis tyre).
- Ngritja e kapaciteteve është thelbësore: partnerët socialë dhe OShC-të (veçanërisht ato lokale) kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme për të marrë pjesë në mënyrë domethënëse në politikëbërje, për të kërkuar projekte të synuara për ngritjen e kapaciteteve dhe për të zhvilluar aftësitë e advokimit; BE-ja duhet të kërkojë sistematikisht përfshirjen reale të shoqërisë civile në politikëbërje.
- OShC-të mund të luajnë një rol kyç në mbështetjen e informimit të publikut dhe rritjen e ndërgjegjësimit rreth procesit të anëtarësimit. Për më tepër, lidhjet më të ngushta me organizatat homologe të BE-së gjatë procesit të negociatave do të mundësonin shkëmbimin e praktikave më të mira.

- Strukturat e politikave për të rinjtë ekzistojnë (duke përfshirë këshillat rinorë), por shpopullimi dhe emigrimi i të rinjve kërkojnë dialog të vazhdueshëm dhe politika largpamëse.
- Rrjetet e shoqërisë civile kundër korrupsionit theksojnë ndjekjen e pamjaftueshme të rasteve të nivelit të lartë dhe mangësi të vazhdueshme në fushën e konfiskimit të asetëve; ato gjithashtu nënvizojnë nevojën për mekanizma mbikëqyrës të konsoliduar për fondet e BE-së për të zbutur rreziqet e korrupsionit.

Situata e dialogut social dhe komunitetit të biznesit

Pikat kryesore:

- Dialogu social zhvillohet rregullisht në Këshillin Ekonomik dhe Social (ESC), por perceptohet si jo i gjerë dhe procedural, me një fokus joproporcional në pagën minimale dhe diskutime të kufizuara mbi reformat më të gjera (p.sh., produktiviteti, mospërputhjet e aftësive, ndryshimet teknologjike ose propozimet madhore legislative, siç janë ndryshimet në ligjin për punën).
- Efektiviteti i ESC-së është i kufizuar nga burimet e kufizuara dhe pjesëmarrja jokonsistente e qeveritarëve. Besimi midis partnerëve trepalësh mbetet i ulët; çështjet e ndjeshme shpesh shmangen, pavarësisht rolit konsultativ të ESC-së. Nevojitet një debat më i hapur dhe më respektues, me mundësinë e ftimit të aktorëve të jashtëm (duke përfshirë OShC-të), sipas rastit.
- Kontratat kolektive ekzistojnë (marrëveshjet e përgjithshme në sektorin publik dhe privat, si dhe marrëveshjet sektoriale), por ciklet e negociimit dhe rishikimit do të ishin më efektive nëse do të rritej dinamizmi, veçanërisht në sektorin privat.
- Standardet ndërkombëtare të punës mbeten pikë referimi: pas një misioni të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) në tetor të vitit 2023 në lidhje me Konventën nr. 98, një sërë rekomandimesh u nxorën në mars të vitit 2024, të cilat janë ende në fuqi; një shembull i reformës është heqja e kërkesës që Ministria e Financave të miratojë në mënyrë retrospektive marrëveshjet kolektive të sektorit publik.
- Mosmarrëveshjet mbi përfaqësimin vazhdojnë të ndikojnë në pjesëmarrjen sindikale: Komisioni për Përfaqësimin rifilloi punën në qershor të vitit 2025 pas një periudhe të gjatë pasiviteti, por ende ka mosmarrëveshje se cila sindikatë duhet të mbajë vendin e tretë në ESC.
- Shqetësimet vazhdojnë në lidhje me reformat e ligjit për punën që po shtyhen përpara pa konsultime të mirëfillta me partnerët socialë, duke përfshirë zbatimin e vazhdueshëm të ligjit të posaçëm (*lex specialis*) të lidhur me ndërtimin e Korridorit panevropian VIII (i cili parashikon orare të zgjatura pune); raportet për presione politike dhe sulmet e herëpashershme kundër drejtuesve të sindikatave përbëjnë gjithashtu shkak për shqetësim.
- Marrëdhëniet punëdhënës-sindikata cenohen nga nivelet e ulëta të besimit të ndërsjellë dhe stimujt e pamjaftueshëm për punëdhënësit që të bëhen pjesë e organizatave të punëdhënësve. Bashkëpunimi midis partnerëve socialë dhe OShC-ve mund të shqyrtohet, duke ruajtur fokusin dhe përfaqësimin e mekanizmave të dialogut.
- Tregu i punës përballet me presione strukturore: emigrimi i shoqëruar me mbërritjen e punëtorëve imigrantë; sfidat në zonat e tregtisë së lirë (duke përfshirë aksesin e kufizuar për partnerët socialë); dhe hendeqet midis vendeve të lira të punës dhe shkallës së regjistruar të papunësisë. Duhet t'i kushtohet vëmendje aspekteve gjinore (punë e denjë për gratë dhe ndarje më e mirë e të dhënave sipas gjinisë).

- Informaliteti, korrupsioni dhe klientelizmi vazhdojnë të cenojnë besimin dhe konkurrencën e drejtë. Mbështetja e shtuar dhe e qëndrueshme për ngritjen e kapaciteteve (financim dhe aftësim) për partnerët socialë, me mbështetjen e ILO-s dhe Komisionit Evropian, konsiderohet si parakusht për një dialog social më domethënës.

Mundësimi i hapësirës për veprim të shoqërisë civile, lirisë së shprehjes dhe luftës kundër keqinformimit

Pikat kryesore:

- Kuadri ligjor për pjesëmarrjen e shoqërisë civile është kryesisht i zbatueshëm, por zbatimi i tij është i pabarabartë dhe ekziston rreziku që konsultimi të bëhet thjesht një formalitet burokratik;
- Këshilli Kombëtar për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile ka rifilluar punën pas një ndërprerjeje dyvjeçare dhe aktualisht mblidhet rregullisht (përbëhet nga 14 përfaqësues OShC-ve, 13 përfaqësues institucionalë dhe një kryetar nga shoqëria civile). Fusha e veprimit të tij përqendrohet kryesisht në legjisllacionin që lidhet me shoqërinë civile dhe ndërveprimi i tij me ESC-në është i kufizuar.
- Miratimi i ligjit të ri “Për shoqatat dhe fondacionet”, i përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, pritet me interes të madh. Ndërsa procesi në përgjithësi paraqet një nivel të kënaqshëm transparence, afatet tejet të ngushta të konsultimit (ndonjëherë vetëm dy ditë), së bashku me perceptimet e favorizimit politik, cenojnë besimin ndaj procesit.
- Hapësira për veprim e shoqërisë civile duhet të konsiderohet si një tregues kyç i funksionimit të demokracisë. Autoritetet dhe OShC-të duhet të shkojnë përtej retorikës konfrontuese dhe të nxisin bashkëpunimin e bazuar në partneritet, duke ruajtur njëkohësisht pavarësinë e shoqërisë civile si mbrojtëse e vlerave themelore dhe si nxitëse e ndryshimit.
- Financimi mbetet një çenueshmëri strukturore: mbështetja shtetërore është e kufizuar dhe shpesh i jep përparësi organizatave fetare/kulturore, ndërsa mbështetja të donatorët e huaj po bëhet gjithnjë e më e pasigurt, pasi disa donatorë po zvogëlojnë ose ridojnë financimin e tyre. Kjo nënvizon nevojën për të diversifikuar burimet e financimit dhe për të vendosur standarde të qarta dhe transparente për financimin publik (duke përfshirë përmes një kodi të praktikave të mira) dhe masa mbrojtëse për të parandaluar financimin e OShC-ve që nuk kanë kredibilitet. OShC-të që ofrojnë shërbime konsiderohen me përparësi të ulët për mbështetje publike.
- Fushatat e shpifjes dhe sulmet e organizuara në internet kontribuojnë në retorikën kundër OShC-ve dhe mosbesimin ndaj tyre, veçanërisht kundër organizatave të advokimit (p.sh. atyre që angazhohen në luftën kundër korrupsionit dhe pro sundimit të ligjit).
- Liria e medias është relativisht më e mirë se në shumicën e vendeve të rajonit, megjithatë disa sfida mbeten ekzistuese (klientelizmi, mungesa e profesionalizmit, vetëcensurimi i lidhur me varësinë nga reklamat, polarizimi dhe ndikimi i huaj). Transparenca në pronësinë dhe financimin e medias duhet të harmonizohet më tej me rregullat e BE-së.
- Paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike mbeten një shqetësim serioz. Vendimi i Gjykatës së Apelit kundër Laboratorit të Raportimit Investigativ (IRL) konsiderohet si precedent negativ, duke përforcuar nevojën për reformë gjyqësore dhe masa mbrojtëse ligjore, si dhe harmonizim me standardet evropiane kundër SLAPP-ve; krijimi i një task-force/grupi pune të dedikuar është një hap pozitiv, por procedurat e zgjatura mund të vijnë të kenë një efekt frenues.

- Keqinformimi po perceptohet gjithnjë e më shumë si një sfidë ndaj demokracisë dhe sigurisë.

Reagimet duhet të kombinojnë rregullimin, mbështetjen për gazetarinë e pavarur, nismat praktike të edukimit mediatik dhe bashkëpunimin me OShC-të për të garantuar që qytetarët të marrin informacion të besueshëm dhe në kohë.

- Në nivel BE-je, roli i KESE-s në Komitetin Drejtues të Platformës Strategjike të Shoqërisë Civile të BE-së pritet të kontribuojë në lidhjen e OShC-ve të Ballkanit Perëndimor me strukturat e BE-së. Programi i propozuar “AgoraEU” (2028-2034) do të konsolidonte dhe zgjeronte mbështetjen në fusha të tilla si kultura/media dhe demokracia.

Sekretariati i Seksionit për Marrëdhëniet e Jashtme (REX)